



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 20 prot.

Elbasan, me 05.01.2021

VENDIM

Nr 4 datë 05. 01.2021

**"Për
dhënie me qira ambientet e UE-së"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, VKM-së Nr.54, datë 05.02.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Dhënie me qira të mjediseve të mëposhtme:
 - a) Mjedisi në godinën e Korpusit Kryesor, në ambientet e brendshme ngjitur me amfiteatrin (poshtë shkallëve të tij), me sipërfaqe 34.8 m², i ndërtuar posaçërisht për shërbime ndaj studentve, me aktivitet: Librari Universitare, shërbime fotokopje, kacelari;
 - b) Mjedisi në anën e jashtme të godinës së korpusit kryesor, ngjitur më të, nga jashtë portës nga ana e amfiteatrit, jashtë godinës, në anën ku janë zyrat e administratës me sipërfaqe ndërtese 123.75 m² dhe sipërfaqe funksionale 41 m², për ushtrimin e aktivitetit: tregtim ushqimi të shpejtë, kafe, kakao, çaj dhe pije freskuse në shërbim të personelit të universitetit dhe studentëve;
 - c) Mjedisi brenda godinës së Fakultetit Ekonomik me sipërfaqe ndërtese 68.3 m² dhe trualli i lirë funksional 57.2 m², për ushtrimin e aktivitetit: tregtim ushqimi të shpejtë, kafe, kakao, çaj dhe pije freskuse në shërbim të personelit të universitetit dhe studentëve.
2. Afati i dhënies me qira të jetë për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga momenti i skadimit të kontratës së mëparshme, me të drejtë ripërtëritje.
3. Në zbatim të Urdhrit nr. 190, datë 19:03.2020 "Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jo-publike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19" të MShMS-së, të respektohen oraret e funksionimit të aktivitetit në këto mjedise.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" për realizimin e procedurës, nënshkrimin e kontratës së dhënies me qira.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DURMISHI**

